

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Më matën aurën dhe më dhanë ilaçe homeopatike"/ Detaje tronditëse nga klinika e mjekëve të arrestuar pas vdekjes së Mazonakis
ADRESA	https://www.gazetatema.net/lifestyle/me-maten-auren-dhe-me-dhane-ilace-homeopatike-detaje-tronditese-nga-kl-i587004
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 06:54:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 07:35:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	973f8062f01caf1aa705a9d39f71ebbc25f704a13e3e7d12a9c7d41cc03e71a1
TEKSTI	95f5f037fbcaea9c91c6164aa8e5b874504ad9084be71a1e761ec457f0ba713c
PAMJA	8691ab4d164146a1be95032b81fdffab6f50b752782a10b725c37f482c79e122

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d88b2ce760e23cc805bd4941007caf1a9c7e812565b44e989ce987d8f0cc8fe0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d88b2ce760e23cc805bd4941007caf1a9c7e812565b44e989ce987d8f0cc8fe0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



le "Prania Besnike", zbardhen raportimet nga qarqet/ Qindra ankesa te mbledhura, Rama: Procesi duhet te vijoje sipas objektivaveNdahet nga jeta Sandro Mazzola, ikona e fundit

“Më matën aurën dhe më dhanë ilaçe homeopatike”/ Detaje tronditëse nga klinika e mjekëve të arrestuar pas vdekjes së Mazonakis



19 Shtator 2026, 09:35Lifestyle TEMA



Akuza të reja kanë dalë në dritë lidhur me metodat e përdorura nga mjekët Karneadou, Elias Theodoropoulos dhe Ioanna Gaka, të cilët ndodhen në paraburgim në kuadër të hetimeve për vdekjen e këngëtarit Giorgos Mazonakis. Një person që pretendon se është trajtuar në klinikën e mjekëve ka përshkruar për televizionin Mega një sërë metodash që, sipas tij, janë përdorur gjatë vizitës. Ai tha se iu nënshtrua një ekzaminimi të cilin mjeku ia paraqiti si një lloj “skanimi” të trupit.

“Më vuri në një makinë që të shkelja në tokë me këmbë të zbathura dhe të prekja disa sipërfaqe me duar, gjithashtu të zbathura. Më pas më bëri atë që supozohej të ishte një ‘skanim’ i trupit tim, që tregonte se ku isha i ndjeshëm”, deklaroi ai.

Sipas tij, pas ekzaminimit iu dhanë edhe rezultate në formën e një raporti, ku përcaktoheshin problemet që pretendoheshin se kishin, ushqimet që nuk duhej të konsumonte dhe në kopertinë ishin listuar ilaçe homeopatike që duhej të përdorte. Ankuesi tha gjithashtu se iu vendosën elektroda në kokë, duar dhe këmbë dhe se mjeku pretendonte se mund të përcaktonte gjendjen e tij fizike dhe psikologjike duke “matur aurën”.

“Më uli në një karrige, vendosi këto elektroda dhe gjoja mati aurën në kompjuter. Në fund, më tregoi aurën dhe, gjoja, gjendjen psikologjike në të cilën isha dhe gjendjen e trupit”, rrëfëu ai. Sipas dëshmisë së tij, rezultati i paraqitur ishte me ngjyrë të verdhë dhe mjeku i tha se kishin disa probleme gjinekologjike. Ai shtoi se i ishte thënë gjithashtu se kishin stomak të ndjeshëm, se problemet ishin të lidhura me gjendjen psikologjike dhe se vuante nga ankthi. Në kuadër të hetimeve janë bërë publike edhe dëshmi nga stafi i klinikës. Një sekretare e zyrës së njërit prej mjekëve tha se e kishte parë Giorgos Mazonakis kur ai kishte mbërritur në klinikë.

Ajo deklaroi se këngëtarin kishte ardhur rreth orës 14:00-14:30 dhe se e kishte përshëndetur. Sipas saj, Mazonakis ishte përshëndetur gjithashtu me një person tjetër që ndodhej në klinikë dhe më pas kishte hyrë në një ambient tjetër. Sekretarja tha se e dinte se Mazonakis kishte planifikuar një takim, por nuk mund të konfirmonte nëse ai e kishte kryer atë, pasi nuk ishte në turnin e saj në atë moment. Ajo shpjegoi gjithashtu se në klinikë listat e takimeve fshiheshin në fund të ditës. Sipas saj, të dhënat e pacientëve ruheshin në pajisjen ku kryhej ekzaminimi dhe mund të riktheheshin përmes historikut të saj.

“Sigurisht, në aparatin ku bëhet ekzaminimi ka një histori. E gjithë baza e të dhënave mbahet atje, emri, data e lindjes, telefoni celular, gjatësia dhe pesha”, tha ajo. Sekretarja tha se kishte qenë e pranishme edhe gjatë një kontrolli në klinikë dhe se pajisja për të cilën bëhej fjalë nuk ishte fshehur.

“Makina nuk ishte aspak e fshehur”, deklaroi ajo, duke shtuar se pajisja ishte përdorur për ekzaminimet e pacientëve. Ajo përshkroi gjithashtu situatën në klinikë në ditën kur Mazonakis kishte qenë aty. Sipas dëshmisë së saj, njëri prej mjekëve ishte shtrirë në divan për të pushuar përpara takimit të radhës, ndërsa Mazonakis ndodhej në një dhomë tjetër me një mjeke. Sekretarja tha se atmosfera në klinikë ishte e qetë dhe se nuk kishte vënë re ndonjë situatë të pazakontë në atë moment.

Në dëshminë e saj, sekretarja foli edhe për pastrimin që u krye në klinikë pasi shërbimet e urgjencës kishin mbërritur dhe kishin marrë Mazonakisin. Ajo e përshkroi këtë veprim si të pazakontë, por tha se mund të kishte qenë pjesë e procedurave rutinë të pastrimit dhe sterilizimit të ambientit. “Po, mund të jetë një procedurë normale që vajzat e bëjnë para se të mbyllen ose para se të largohen”, deklaroi ajo, duke shtuar se nuk e dinte nëse pastrimi ishte kryer në mënyrë automatike për shkak të situatës së krijuar apo nëse ishte bërë me udhëzim të mjekëve. Hetimet për rrethanat e vdekjes së Giorgos Mazonakis vijojnë, ndërsa dëshmitë e stafit dhe pretendimet e personave që kanë trajtuar në klinikë po shqyrtohen nga autoritetet.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Earl Spencer zbulon prapaskenën e bujshme: Mbretëresha Elizabeth donte t'i rikthente Dianës titullin mbretëror pas vdekjes](#)

17:27 Lifestyle

[Lady Gaga e solli në jetë fëmijën e saj nëpërmjet një nëne zëvendësuese](#)

16:23 Lifestyle

["Nuk mund ta lija jetim" - Pse nuk u bë kurrë baba? Rrëfëhet Spartak Ngjela](#)

15:40 Lifestyle / 13 komente

Pas më shumë se 100 vitesh, zbulohet një specie e re maceje, është më e vogël se një mace shtëpie

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.